



NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Në zbatim të Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Dokumentit me nr. 6694/1 prot., datë 29.12.2023, “Manuali i Burimeve Njerëzore të OST sh.a.”, si dhe Dokumentit me nr. 3329/2 prot., datë 28.05.2021, “Detyrat funksionale dhe kriteret e punësimit për pozicionet e punës në Njësitë Operative dhe Njësinë e Mirëmbajtje Transmetimit” (i rishikuar), OST sh.a. shpall procedurën e rekrutimit për pozicionin e mëposhtëm:

Përgjegjës Sektori në Sektorin e Mirëmbajtjes së Linjave Vau i Dejës, Njësia Operative Shkodër (NJOSH)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Në bashkëpunim me Sektorin (Repartin) e Shfrytëzimit harton projekt-planin grafik të remonteve të linjave që ka në administrim Njësia;
- Ndjek kryerjen e të gjitha kontrollet profilaktike, kontrollet periodike mujore, kontrollet me hypje në shtyllë, kontrollet natën në shtyllat ankerore dhe bashkimet e përcjellsave si dhe kontrollet në raste të stakimeve të linjave në avari nga shkarkimet atmosferike apo kontaktet me objekte të jashtme;
- Ndjek kryerjen e të gjitha remontet e linjave të tensionit të lartë sipas grafikut të miratuar vjetor, apo remonte të detyruar nga gjendja avari e tyre;
- Merr pjesë në analizat e avarive apo defekteve që kanë ndodhur në linjat që administron Njësia Operative;
- Ndjek kryerjen e të gjitha punimeve të nevojshme në linja, që kryhen pa heqjen e tensionit në to si: pastrimet e traseve të tyre, plotësimet me profile, në rast se ka të hequra, kontrollet e bazamenteve dhe të tokëzimeve, riparimi i tyre dhe i kokave të bazamenteve, plotësimi me tabelat e sigurimit teknik etj;
- Plotëson dhe mirëmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e të gjithë kontrolleve dhe remonteve të linjave dhe të gjithë punimeve të tjera që kryhen në to;
- Trajnon brigadat e linjave në lidhje me kryerjen e kontrolleve dhe metodikat e kryerjes të remonteve në linjat e tensionit të lartë;
- Përcakton nevojat për materiale, vegla pune apo paisje që shërbejnë për remontin dhe mirëmbajtjen e linjave të tensionit të lartë që ka në administrim Njësia Operative;



Kërkesat e përgjithshme, që duhet të plotësojë kandidati për punësim:

- Të ketë shtetësinë shqiptare;
- Të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të përmbushë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës sipas kritereve të miratuara;
- Të jetë i aftë për punë;
- Të mos jetë i dënuar me një vendim gjykate të formës së prerë;
- Të gëzojë integritet moral dhe profesional, si dhe të mos jetë marrë masa disiplinore për cënim të rregullave të etikës;
- Të mos ketë lidhje familjare me punonjës të tjerë të administratës me të cilët kanë lidhje hierarkie;
- Personat që kandidojnë për këtë pozicion, duhet të kenë të paktën 3 -vite eksperiencë pune në fusha relevante.

ARSIMI I KËRKUAR:

I lartë - Inxhinieri elektrike/ Mekatronike/ Mekanike (Master shkencor ose Diplome ekuivalente).

Dokumentat për dorëzim

Faza e Vlerësimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së Arkivë-Protokollit, në Aparatin Qendror të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose nëpërmjet postës elektronike: info@ost.al, këto dokumente:

1. Curriculum Vitae (CV)
2. Dëftesë e arsimit të lartë
3. Çertifikime të tjera relevante

Dokumentacioni i dorëzuar nuk do të kthehet mbrapsht, pasi bëhet pjesë e arkivës së Institucionit.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit duhet të bëhet brenda datës 31.03.2024.



Mënyra e vlerësimit:

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Në lidhje me intervistën e punës kandidatët do të vlerësohen për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e përzgjedhur.

Dokumentat për dorëzim

Faza e lidhjes së kontratës:

1. Libreza e punës (nëse ka) ose vërtetim për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore
2. Fotokopje e noterizuar diplomës së bashku me listen e notave
3. Vërtetim shëndetësor nga Komisioni Mjeko-Ligjor
4. Fotokopje ID
5. Dëshmi penaliteti
6. Vërtetim nga gjykata
7. Vërtetim nga prokuroria
8. Çertifikatë familjare
9. Dëshmi të ndryshme kualifikimi

###